



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 janar 2020
Nr. ref.:RK 1503/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI55/19

Parashtrues

Ramadan Osmani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
PML.nr.248/18 të 6 nëntorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ramadan Osmani (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Vushtrri, të cilin e përfaqëson Mahmut Halimi, avokat nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PML.nr.248/18, të 6 nëntorit 2018 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i kontestuar), në ndërlidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR.nr.91/2018, të 10 prillit 2018 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.610/2015, të 21 nëntorit 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], paragrafët 1, 2 dhe 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor], paragrafi 2, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj), dhe nenin 11 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNj.)

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 prill 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 10 prill 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 17 maj 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme. Të njëjtën ditë, Gjykatës Themelore në Prishtinë iu kërkuar fletëkthesa si dëshmi e pranimit të Aktgjykimit të kontestuar nga ana e parashtruesit të kërkesës.
8. Më 12 qershor 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë e informoi Gjykatën se Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 6 dhjetor 2018.
9. Më 12 dhjetor 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 31 tetor 2012, ish Prokuroria e Qarkut, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë, kundër parashtruesit të kërkesës dhe disa të akuzuarve të tjerë ngriti aktakuzë për shkak të dyshimit të bazuar të kryerjes së veprës penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 147 paragrafi 4 dhe 9, lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe veprës penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje e në tentativë nga neni 147 paragrafi 4 dhe 9 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPRK-së.
11. Më 21 nëntor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me Aktgjykimin PKR.nr.610/2015, parashtruesin e kërkesës e shpallë fajtor për kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje, nga neni 147. paragrafi 4 dhe 9 i KPRK-së dhe e liron atë nga aktakuza për veprën penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje e në tentativë nga neni 147, paragrafi 4 dhe 9, lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPRK-së. Parashtruesi i kërkesës me këtë rast u dënua me burgim, në kohëzgjatje prej 13 vjetësh.
12. Më 5 shkurt 2018, parashtruesi i kërkesës e apeloj Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 21 nëntorit 2015, në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënim, duke propozuar që Gjykata e Apelit të aprovojë ankesën e tij, ta ndryshojë Aktgjykimin e atakuar dhe të njëjtin ta lirojë nga akuza apo të anulojë Aktgjykimin dhe lënda të kthehet në rigjykim ose të njëjtit t'i shqiptohet dënimi më i butë.
13. Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe mbrojtësi i të dëmtuarës apelian Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së Ligjit Penal, duke kërkuar që të akuzuarve t'iu shqiptohet një dënim më i lartë me burgim.
14. Më 10 prill 2018, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PAKR.nr.91/2018, e ndryshoi Aktgjykimin e 21 nëntorit 2015, sa i përket kualifikimit të veprës penale, duke konstatuar se në lidhje me veprimet e parashtruesit të kërkesës dhe të dy të akuzuarve të tjerë janë të pranishëm elementet e veprës penale nga neni 147, paragrafi 9 i KPRK-së, lidhur me nenin 23 të KPRK-së, ndërsa në pjesët e tjera, ankesat e Prokurorisë Themelore, të mbrojtësit të të dëmtuarës dhe të parashtruesit të kërkesës, i refuzoi si të pabazuara.
15. Më 23 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, për shkak të pretendimeve për shkelje të ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozimin që i njëjti të lirohet nga akuza pasi që nuk është provuar se ka kryer veprën penale për të cilën është ngarkuar dhe dënuar, ose aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe lënda të kthehet në rigjykim.
16. Më 6 nëntor 2018, Gjykata Supreme me Aktgjykimin Pml.nr.248/2018, e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ushtruar nga parashtruesi i kërkesës, kundër Aktgjykimeve të shkallës së parë dhe të

shkallës së dytë, duke vërtetuar se gjykatat e instancës më të ultë kanë arsyetuar mjaftueshëm konkluzionet e tyre të cilat e bëjnë procesin të rregullt dhe të paanshëm, në pajtueshmëri me standardet e kërkuara me KEDNJ.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Pml.nr.248/18 të 6 nëntorit 2018: *“është refuzuar si e pa bazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e që konsiderojmë se të gjitha aktgjykimet e cituara janë të kundërligjshme dhe në kundërshtim me dispozitat kushtetuese.”*
18. Fillimisht parashtruesi i kërkesës përshkruan përmbajtjen e nenit 31, paragrafët 1, 2 dhe 5 të Kushtetutës, duke argumentuar se: *“Burimi i kësaj garance rrjedh nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara në artikullin 11, sipas së cilës barra e provës i takon prokurorit, e cila duhet të mbledhë dhe të paraqes mjaft dëshmi bindëse për të bindur trupin gjykues, i cili është i kufizuar nga ligji që të marrë parasysh vetëm prova dhe dëshmi që janë ligjërisht të pranueshme dhe të marra në mënyrë të ligjshme, që vërtetojnë se i pandehuri është fajtor përtej dyshimit të arsyeshëm, dhe se nëse pas punës së prokurorisë mbetet dyshim i arsyeshëm atëherë i akuzuari duhet të shpallet i pa fajshëm. Poashtu kjo garancë përforcohet edhe me artikullin 6.2 të KEDNJ, e cila sipas dispozitës së nenit 22 të Kushtetutës ka prioritet ndaj dispozitave të ligjeve të kateve tjera të institucioneve publike.”*
19. Pretendimet e tij për shkeljen e të drejtave dhe të lirive të garantuara me nenin 31, paragrafët 1 dhe 5 të Kushtetutës parashtruesi i kërkesës i ndërlidhë me vendimet e gjykatave të rregullta përkatësisht me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.610/2015 të 21 nëntorit 2017 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR.nr.91/2018 të 10 prillit 2018.
20. Në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.610/2015 të 21 nëntorit 2017, parashtruesi i kërkesës pretendon se: *“Përfshihet me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, neni 384, par. 1, nënpar. 1.8, dhe 1.12 të KPPK, në aktgjykimin e shkallës së parë e të cilat qëndrojnë në faktin se i njëjti mbështetet në prova të pa pranueshme si dhe nuk është përpiluar në harmoni me dispozitën e nenit 370 të KPPK, në veçanti me par. 7. të nenit të përmendur. (...)”*
21. Parashtruesi i kërkesës thekson se gjykata e shkallës së parë ka përdoruar prova në kundërshtim me nenin 361. par. 1 të KPPK *“duke përdorur si prova të drejta për së drejta procesverbalet mbi marrjen në pyetje në procedurë paraprake të të gjithë dëshmitareve, përkundër faktit se të njëjtit i ka dëgjuar në shqyrtim gjyqësor.”*
22. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, pretendon se është vepruar në shkelje të nenit 123. par. 2 të KPPK, *“në raport me deklaratat e të pandehurve të dhëna në procedurë paraprake, pra edhe të dënuarit A.K., në raport me fajësinë e të dënuarit Ramadan Osmani. Kjo për arsyen se me dispozitën e nenit 261. par 1. të KPPK., për vet të pandehurin (por JO edhe për të bashkëpandehurit) deklaratat e dhëna në polici ose para prokurorit mund të përdoren për ta*

kundërshtuar deklarin e të pandehurit në gjyq ose si provë e drejtpërdrejtë në pajtim me nenin 262. par. 2 të KPPK. Të gjitha këto paraqesin një shkelje e cila është në kundërshtim me dispozitën e nenit 123. par. 2 të KPPK, përkundër faktit se kjo ka të bëjë me vet të pandehurin që ka dhënë deklaratën e tillë e jo edhe për të pandehurit tjerë, për çfarë duke qene e ndaluar analogjia në interpretim të çfarëdo dispozite, dispozita e nenit 123. par.5. të KPPK është mese e qarte: "Deklaratat e dhëna nga i pandehuri në çfarëdo konteksti, nëse janë dhënë në mënyrë vullnetare dhe pa shtrëngim, janë prova të pranueshme gjatë shqyrtimit gjyqësor kundër të pandehurit, por jo edhe kundër të bashkëpandehurve ...".

23. Parashtruesi i kërkesës në veçanti pretendon se nuk ka pasur mundësi për të kundërshtuar dëshmitarin dhe njëkohësisht të dënuarin A.K., duke qenë se ky dëshmitar ka dhënë deklarin e tij në fazën e hetimeve ku parashtruesi i kërkesës dhe mbrojtësi i tij nuk kanë qenë prezent, ndërsa në fazat e tjera dëshmitari ka vendosur të qëndrojë në heshtje.
24. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se përdorimi i deklaratave të dhëna në procedurën paraprake si prova të drejtpërdrejta me rastin e marrjes së aktgjykimit, si dhe *"krahësimi i deklaratave të dëshmitarëve në mes të asaj çfarë kanë deklaruar në procedurën paraprake e çfarë në shqyrtimin gjyqësor dhe dhënia e fuqisë së besueshmërisë atyre deklaratave të dhëna në procedurë paraprake për arsyen e njëjte se prekë standardin e vlerësimit të provës dhe përdorimin e sajë me rastin e arsyetimit të aktgjykimit."* Parashtruesi i kërkesës në lidhje me këtë pretendim i referohet rastit Drenica 1, duke u thirrur në interpretimet e dhëna në paragrafin 208 (fq. 78) përkatësisht Aktgjykimit P.nr.938/13, të 27 majit 2015.
25. Gjithashtu parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.610/2015, të 21 nëntorit 2017, janë shkelur dispozitat e nenit 370 para. 7 të KPPK-së, pasi që, sipas tij *"aktgjykimi i shkallës së parë është në kundërshtim me dispozitivin e aktgjykimit"* sa i përket përshkrimit të veprimeve të parashtruesit të kërkesës në kryerjen e veprës penale, si dhe dëshmitë e dhëna nga dëshmitaret rreth identifikimit të parashtruesit të kërkesës.
26. Në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR.nr.91/2018 të 10 prillit 2018, parashtruesi i kërkesës pretendon se: *"Aktgjykimi i shkallës së dytë ka dështuar në tërësi të respektoj dispozitën e nenit 394. par.1 të KPPK., pasi i njëjti nuk ka shqyrtuar fare pretendimet ankimore të mbrojtësit të dënuarit Ramadan. Ky dështim vije në shprehje në vërtetimin e elementit kyç për të dënuarin Ramadan se a ishte ai në vendin e ngjarjes kur u vra tani i ndjeri ..."*
27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së dytë në fq. 7 (fillimi i faqes) në shkelje të dispozitës së nenit 360 para.1. të KPPK., cenohet parimi i identitetit objektiv të aktgjykimit të shkallës së parë dhe akuzës"* për shkak të *"mënyrës se si është arsyetuar kjo pjesë, gjykata e shkallës së dytë ka tejkaluar akuzën përkatësisht identitetin objektiv dhe subjektiv të saj."*

28. Parashtruesi i kërkesës më tej argumenton se *“gjkata e shkallës së dytë ka qenë e obliguar të jap shpjegime në pretendimet ankimore të paraqitura ndaj aktgjykimit të shkallës së parë të dhënë në faqen 35, pasusi i parë”* (parashtruesi i referohet Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR.nr.91/2018).
29. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me arsyetimin e dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.610/2015 të 21 nëntorit 2017, në lidhje me vërtetimin e provave dhe dëshmive për vërtetimin e veprimeve inkriminuese të të akuzuarave përfshirë edhe vet parashtruesin e kërkesës (parashtruesi i referohet arsyetimit të dhënë nga Gjykata e Apelit PAKR.nr.91/2018, fq.8). Në lidhje me këtë mospajtim, parashtruesi i kërkesës paraqet një përshtkrim të detajuar të fakteve të cilat sipas parashtruesit *“një përshtkrim i tillë është i domosdoshëm mu për shkak të pasojave që kanë shkaktuar të dy aktgjykimet për të dënuarin Ramadan dhe atë jo vetëm për shkak të gjendjes së paraqitur faktike por në veçanti të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe të shkeljes së ligjit penal e që në mënyrën më të rëndë kanë shkelur parimet e pretenduara kushtetuese në këtë kërkesë.”* Përshtkrimi në fjalë paraqet shpjegimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me validitetin e dëshmive të dëshmitarëve dhe me identifikimin e parashtruesit si person i implikuar në vrasjen e 6 gushtit 2011, dhe ngjarjen tragjike (shih, faqet 11-22 të kërkesës së parashtruesit).
30. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata: *I. Ti shpallë si kundër kushtetuese: i) aktgjykimin PKR.nr.610/2015, të dt.21.11.2017 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ii) Aktgjykimin PAKR.nr.91/18, të dt.20.04.2018, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, dhe, iii) Aktgjykimin Pml.nr.248/2018 të dt.06.11.2018, të Gjykatës Supreme të Kosovës; II. Të urdhëroi që të gjitha këto aktgjykime të prishen dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe vendosje pranë gjykatës së shkallës së parë.*

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

33. Gjykata po ashtu i referohet neneve: 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“[...]

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

34. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; i ka shterur mjetet juridike në dispozicion; i ka specifikuar aktet e autoritetit publik të cilat i konteston në Gjykatë dhe gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë kushtetuese të cilat ai pretendon se i janë shkelur me vendimet e kontestuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në kohë, në pajtim me nenin 49 të Ligjit.
35. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:
- “(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*
36. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, në ndërlidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.610/2015, të 21 nëntorit 2017 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR.nr.91/2018, të 10 prillit 2018, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 paragrafët 1, 2 dhe 5 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 paragrafi 2 të KEDNj-së dhe nenin 11 të DUDNj.

37. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës, paragrafi 1, 2 dhe 5 garantojnë:

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.”

[...]

38. Neni 6 [E drejta për një proces të rregullt], paragrafi 2 i KEDNJ-së, garanton:

[...]

“2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.”

[...]

39. Neni 11 i DUDNJ-së, garanton që:

“Secili që akuzohet për një vepër penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm derisa në bazë të ligjit të vërtetohet fajësia në një proces publik në të cilin i sigurohen të gjitha garancitë e nevojshme për mbrojtjen e tij.”

40. Gjykata verën se parashtuesi i kërkesës pretendimet për shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 31, paragrafët 1, 2 dhe 5, me nenin 6, paragrafin 2 të KEDNJ dhe nenin 11 të DUDNJ, i ndërlidhë me mënyrën se si gjykatat e rregullta i) administruan provat (barra e provës), ii) vlerësuat dëshmitë e dëshmitarëve, dhe iii) arsyetuan vendimet përkitazi me zbatimin e të drejtës materiale dhe procedurale.

41. Gjykata fillimisht thekson se, sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, *“të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*

i. Pretendimet e parashtuesit përkitazi me administrimin e provave (barrës së të provuarit)

42. Sa i përket administrimit të provave dhe barrës së të provuarit Gjykata rikujton praktikën e saj, ku kishte theksuar se, *“është përtej juridiksionit të saj që të*

vlerësojë cilësinë e konkluzioneve të gjykatave lidhur me vlerësimin e provave, përveç nëse ato janë haptazi arbitrare. (shih, për më tepër, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, në rastet KI10/15 dhe KI12/15, me parashtrues *Shpresim Uka dhe Bekim Syla*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 korrikut 2016, si dhe rastet e bashkuara KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, me parashtrues *Arben Gjukaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 26 shtatorit 2016). Gjykata, ripërsëritë se nuk është kompetencë e saj të ndërhyjë, as në mënyrën se si gjykatat e rregullta kanë pranuar provat si material dëshmues dhe as në vlerësimin e vlerës dëshmuese. Ky është rol ekskluziv i gjykatave të rregullta, madje edhe kur deklaratat e dëshmitarëve në shqyrtimin publik dhe nën betim janë në kundërshtim (shih, ngjashëm, rastin e GjEDNj-së *Doorson kundër Holandës*, Aktgjykimi i 6 marsit 1996, i publikuar në raportin nr. 1996-II, paragrafi 78).

43. Gjykata, po ashtu, rikujton praktikën e GjEDNj-së e cila ka përcaktuar se pranimi i provave rregullohet kryesisht nga rregullat e legjislacionit të brendshëm dhe si rregull, janë gjykatat kombëtare ato që duhet të vlerësojnë provat para tyre. Detyra e institucionit të Konventës është të sigurojë që procesi në tërësinë e tij, përfshirë dhe mënyrën se si janë marrë provat, të ketë qenë i rregullt. Këto të drejta kërkojnë që të akuzuarit t'i jepet mundësia e nevojshme dhe e përshtatshme për të kundërshtuar dhe pyetur një dëshmitar kundër tij, qoftë në momentin kur ai bën deklaratat, ose dhe në një fazë të mëvonshme të procedimeve (shih, *Saïdi kundër Francës*, vendim i 20 shtatorit 1993, seritë A nr. 261 – C, fq. 56 § 43, dhe *A.M. kundër Italisë*, nr. 37019/97, § 25, ECHR 1999 –IX, si dhe shih, Gjykata Kushtetuese, në rastin KI82/16, me parashtrues *Đeljalj Kazagić*, Aktvendimin për papranueshmëri, i 1 marsit 2017, paragrafët 53 dhe 54).
44. Për më tepër, Gjykata, duke iu referuar pjesëve relevante të Aktgjykimit të kontestuar dhe pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me administrimin e provave, verën se Gjykata Supreme, argumentoi dhe arsyetoi: “Gjykata e shkallës së parë, ka arritur që përmes provave të administruara në mënyrë bindëse të vërtetoi se i dënuari Ramadan Osmani ka vepruar në bashkëkryerje me të dënuarit e tjerë B.B., A.K., Xh. M. (i cili gjatë zhvillimit të procedurës ka vdekur) si dhe me A.M (i cili gjendet në arrati), ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe me këtë rast, drejtë ka zbatuar ligjin penal, kur ka konstatuar se në veprimet e të dënuarit janë manifestuar elementet qenësore të veprës penale në bashkëkryerje vrasja e rende nga neni 147 par. 9 të KPK-së.”
45. Më tej, Gjykata Supreme, përkitazi me veprimet e parashtruesit me “dashje”, arsyetoi: “Po ashtu edhe përkitazi me dashjen e të dënuarit padyshim se është vërtetuar përmes arsyetimit të gjykatës së shkallës së parë se i dënuari Ramadan Osmani me dashje të drejtpërdrejtë ka vepruar në rastin konkret pasi që ishte në dijeni përkitazi me raportet mes të dy familjeve R dhe M dhe se dashja e tij është përmbushur tërësisht me faktin se "...vrasja ishte shkaktuar për arsye të motiveve të ulëta meqë vrasja ishte shkaktuar mu për arsye të prishjes së martesës në mes të tani të ndjerit M.R me ish gruan e tij R.M, që ishte vajza e Xh dhe motra e A.M ndërsa te akuzuarit e kishin shok të mirë A.M, andaj edhe kishin pranuar të bashkëpunojnë në drejtim të

realizimit të qëllimit të vrasjes së M, për hakmarrje të cilin qëllim e kishin pranuar si të përbashkët (përshkrimi i arsytimit të aktgjykimit të shkallës së parë faqe 39). Në rastin konkret sipas Gjykatës Supreme të Kosovës, nuk është cenuar parimi i prezumimin të pafajësisë dhe se arsytimi i gjykatës së shkallës së parë përkitazi me bashkëkryerjen dhe dashjen e të dënuarit Ramadan Osmani i mbështete në tërësi edhe kjo gjykatë, pasi që mjaftueshëm janë përshkruar dhe elaboruar të gjitha veprimet e tij sipas dispozitivit të aktgjykimit.”

46. Në këtë këndvështrim, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme, nëpërmjet Aktgjykimit të kontestuar i është përgjigjur në mënyrë konkrete pretendimeve të parashtruesit të kërkesës edhe lidhur me administrimin e provave dhe mënyrës se si janë pranuar dhe vlerësuar ato nga gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë. Andaj, në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është i arsytuar dhe nuk përmban elemente të arbitraritetit të dukshëm që do e bënin vendimmarrjen e saj të papajtueshme me standardet e një vendimi të arsytuar dhe të arsyeshëm gjyqësor.

ii. Pretendimet e parashtruesit përkitazi me dëshmitë e dëshmitareve

47. Gjykata, fillimisht rikujton se pranimi si dëshmi i deklaratave të dëshmitarëve që nuk kanë marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor, ngrihet si çështje e rëndësishme nëse deklarata e dëshmitarit është dëshmi “*e vetme*” ose “*vendimtare*” ose nëse e njëjta “*bartë peshë të konsiderueshme*” për dënimin e të akuzuarit. Në rrethana të tilla, dëshmitë tjera ose mbështetëse fitojnë peshë shumë domethënëse. Sa më të forta të jenë dëshmitë tjera inkriminuese, aq më pak ka gjasa që dëshmia e dëshmitarit në mungesë të trajtohet si “*e vetme*” ose “*vendimtare*”.
48. Gjykata gjithashtu rithekson se, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në vlerësimin e peshës së dëshmisë së dhënë nga dëshmitari në mungesë, dhe posaçërisht, nëse kjo dëshmi është “*e vetme apo vendimtare*” për dënimin e të akuzuarit, Gjykata fillimisht duhet të ketë parasysh vlerësimin dhe qëndrimin e gjykatave të rregullta. Kjo qasje është në përputhshmëri, ndër të tjera, me rastin *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*. (Përkitazi me vlerësimin nëse dëshmia e dëshmitarit në mungesë ishte e vetme ose vendimtare për dënimin e të akuzuarit, shih paragrafët 141-144 të rastit *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*). Në anën tjetër, në rastin *Seton kundër Mbretërisë së Bashkuar*, gjykatat vendore si dhe GJEDNJ kishin konstatuar se mungesa e të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor, përkatësisht mungesa e dëshmisë së tij në shqyrtim gjyqësor, nuk përbënte dëshminë as “*të vetme*” dhe as “*vendimtare*”, sepse dëshmitë tjera kundër tij ishin “*dërrmuese*”. (Përkitazi me vlerësimin nëse dëshmia e dëshmitarit në mungesë ishte e vetme ose vendimtare për dënimin e të akuzuarit, shih paragrafët 63-64 të rastit *Seton kundër Mbretërisë së Bashkuar* dhe referencat e përdorura aty).
49. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme dhe vëren se kjo e fundit arsyetoi si në vijim: “*Përkitazi me vlerësimin e dëshmiave të dëshmitareve M.R dhe Sh.R, posaçërisht për identifikimin e të dënuarit Ramadan Osmani dhe A.Sh (i liruar nga akuza),*

përkatësisht gabimeve të tyre në identifikim, edhe përkitazi me këtë gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyetim të hollësishëm. Është e qartë se dëshmitaret okular të vendit të ngjarjes kishin përjetuar një skenë të tmerrshme të vrasjes së djalit të tyre dhe se në këtë kontest edhe jeta e tyre ishte në rrezik dhe po ashtu është e qartë se përveç Xh.M dhe djalit të tij A.M me të cilët paraprakisht kishin pasur lidhje miqësore e të cilët qartazi i identifikuan menjëherë, mirëpo patën vështirësi në identifikimin e edhe të Ramadan Osmanit. Mirëpo te dënuarin Ramadan Osmani e identifikoj pa asnjë mëdyshje i dënuari tjetër A.K e gjithashtu edhe dëshmitaret M.R dhe F.R, pasi që e kishin parë me parë dhe kishin biseduar me të dhe e identifikuan përmes faktit se i njëjti gjatë bisedës me ta kishte belbëzuar që e rrit besueshmërinë e tyre se identifikimi ishte bërë në mënyrë të saktë.

50. Në fund, Gjkata Supreme, konkludoi se: *“Andaj, arsyetimet e aktgjykimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë, i pranon në tërësi edhe Gjykata Supreme e Kosovës, përkitazi me vlerësimin e tërësishëm të mbrojtjes së të dënuarit, dëshmi të dëshmitareve dhe provave materiale, konstatoj se është dhënë arsyetim i ligjshëm dhe i drejtë e që këto konstatime të theksuara kanë përcjellë të gjitha fazat e procedurës penale dhe të dënuarit i është siguruar një proces i drejtë, i rregullt dhe i paanshëm, bazuar në dispozitat e KPPK-së dhe standardet e përcaktuara me KEDLNj.”*
51. Nga arsyetimi i mësipërm i Gjykatës Supreme është e qartë për Gjykatën, se konkluzionet e gjykatave të rregullta, lidhur me fajësinë e parashtruesit të kërkesës u bazuan në disa dëshmi të dëshmitareve. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se nuk bëhet fjalë për dëshmitarë të vetëm, dëshmia e të cilit do të konsiderohej e “vetme” dhe “vendimtare” për gjykimin objektiv të çështjes. Andaj, edhe në lidhje me këto pretendime, Gjykata vlerëson se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është i arsyetuar, në pajtueshmëri më të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

iii. Pretendimet e parashtruesit përkitazi me arsyetimin e vendimeve në lidhje me zbatimin e të drejtës materiale dhe procedurale.

52. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ankohet për mënyrën se si gjykatat e rregullta arsyetuan vendimet e tyre përkitazi me zbatimin e ligjit material dhe procedural. Gjykata, vlerëson këto pretendime, si të tilla, bien në fushëveprimin e gjykatave të juridiksionit të rregullt, sepse tërheqin thjeshtë çështje të ligjit (ligjshmërisë) dhe jo çështje kushtetuese. Gjykata ripërseritë se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit dhe të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Edhe më tej, është detyrë e gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, GJEDNJ rasti *Perlala kundër Greqisë*, paragrafi 25 dhe *Khan kundër*

Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 34, dhe shih, gjithashtu rastet: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011; dhe KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, para. 41). Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore.

53. Në vlerësimin e procesit si tërësi, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme, e cila sipas detyrës zyrtare, kujdeset për ligjshmërinë e vendimeve të gjykatave të instancës me të ulët, iu është përgjigjur të gjitha pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, duke dhënë arsye gjithëpërfshirëse dhe të detajuara për secilin pretendim të ngritur në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Për më tepër, Gjykata Supreme ishte kujdesur edhe për kushtetutshmërinë e vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta, duke konkluduar se, të njëjtat kanë ndjekur në mënyrë të drejtë të gjitha fazat e procedurës penale, për t'i siguruar parashtruesit të kërkesës një gjykim të drejtë dhe të paanshëm në pajtueshmëri me KEDNJ-në.
54. Gjykata, më tej, vlerëson se parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të mjaftueshme që para gjykatave të rregullta t'i prezantojë të gjitha pretendimet për shkelje të të drejtave të tij. Për më tepër, Gjykata konsideron se argumentet e tij janë dëgjuar në mënyrë të rregullt dhe janë shqyrtuar në mënyrë të duhur nga gjykatat e rregullta, posaçërisht nga Gjykata Supreme. Për këto arsye, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është i arsyetuar dhe i arsyeshëm. Për më tepër, Gjykata thekson se procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, nuk kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih rastin e GJEDNJ-së *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Aktgjykim i 30 qershorit 2009).
55. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në mbështetje të pretendimeve të tij i referohet rastit *Drenica 1*, përkatësisht Aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë P.nr.938/13, të 27 majit 2015, duke mëtuar se kjo gjykatë do të duhej vepruar njësoj edhe në rastin e tij, sikurse në atë rast. Megjithatë, i njëjti vetëm i është referuar rastit në fjalë, por nuk ka dorëzuar dëshmi dhe prova materiale në mbështetje të këtij pretendimi, andaj Gjykata nuk mund të bëjë një analizë krahasuese të rasteve për të shikuar nëse ekzistojnë dallime në trajtim. Për më tepër, Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Për këto arsye Gjykata nuk mund t'i marrë për bazë pretendimet e parashtruesit për trajtimin ndryshe të rastit të tij me raste të tjera identike për shkak se në këtë aspekt kërkesa nuk është e mbështetur me prova materiale.
56. Nga të gjitha shtjellimet e mësipërme, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thjeshtë nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, paragrafi 21, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005; shih Aktvendimin për

papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, në rastin: KI25/11, me parashtrues *Shaban Gojnovci*, të 28 majit 2012, paragrafi 28; shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).

57. Si përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të tregojë dhe të provojë se procedurat në gjykatat e rregullta, përkatësisht në Gjykatën Supreme kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë e tij të mbrojtura me Kushtetutë, KEDNj dhe DUDNj i janë shkelur si rezultat i interpretimeve të gabuara të ligjit material dhe procedural.
58. Andaj, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, ajo duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, më 12 dhjetor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Remzije Istrefi-Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi